

Platforma për të Drejtat e Njeriut

Constitutional Articles: Të Drejtat e të Akuzuarit

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim: (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij; (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit; (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi; (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas; (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Constitutional Paragraph: Neni 30 para. 1

(1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij;

Instrumentet ndërkombëtare

Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike
Pakti Nderkombëtar për të Drejtat civile dhe Politike

Nenet

Neni 14 para 3.

Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësisht të barabartë të ketë kështu garanci minimale: (a) Të informohet menjëherë dhe në mënyrë të hollësishme, në një gjuhë të cilën ai e kupton, lidhur me natyrën dhe shkakun e akuzës që ngrihet kundër tij

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj
Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

Neni 6.3 a

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: (a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

Ligjet

Nenet

KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS
KODI NR. 06/L-074 KODI
PENAL I REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

LIGJI NR. 05/L-053 PËR
DHOMAT E
SPECIALIZUARA DHE
ZYRËN E PROKURORIT
TË SPECIALIZUAR
LIGJI NR. 05/L-053 PËR
DHOMAT E
SPECIALIZUARA DHE
ZYRËN E PROKURORIT
TË SPECIALIZUAR

Neni 2

Parimi i ligjshmërisë

1. Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen veçmas me ligj.
2. Askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për veprën nëse para kryerjes së saj nuk është përcaktuar me ligj si veprë penale dhe nuk është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për atë veprë.
3. Përkufizimi i veprës penale duhet të përcaktohet në mënyrë të saktë dhe nuk lejohet interpretimi sipas analogjisë. Në rast paqartësie, përkufizimi i veprës penale interpretohet në favor të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale.

Neni 21

4. Në përcaktimin e akuzave kundër të akuzuarit sipas këtij ligji, i akuzuari gëzon të drejtën e garancive minimale të mëposhtme, me barazi të plotë që:
 - a. të njoftohet me kohë dhe në hollësi në gjuhën që ai e kupton për natyrën dhe shkaqet e akuzës kundër tij,
 - b. të informohet me kohë për të drejtat e tij sipas ligjit,
 - c. të ketë kohën dhe kushtet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij dhe të komunikojë me Mbrojtësin e Specializuar të zgjedhur prej tij,
 - d. të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme, e. të gjykohet me praninë e tij, dhe të mbrohet përmes Mbrojtësit të Specializuar të zgjedhur prej tij; të informohet, nëse nuk ka ndihmë ligjore, për këtë të drejtë; dhe t'i caktohet Mbrojtës i Specializuar, në çdo rast kur kjo kërkohet për interesa të drejtësisë, dhe pa pagesë në rast se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për ta paguar,
 - f. t'i merr në pyetje, ose t'i ketë marrë në pyetje, dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në kushte të njëjta me ato të dëshmitarëve kundër tij,
 - g. të ketë ndihmën falas të përkthyesit, nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret në Dhomën e Specializuar dhe
 - h. të mos detyrohet të dëshmojë kundër vetes apo të pranojë fajësinë

Neni 165

Njoftimi i personit të arrestuar për të drejtat e tij

1. Personi i arrestuar gëzon këto të drejta:

1.1. të informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit;

1.2. të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave mbi identitetin e tij;

1.3. të ketë qasje në shkresat e lëndës, përveç përjashtimeve të parapara në nenin 209 të këtij Kodi

1.4. t'i sigurohet përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e policit; 1.5. të shfrytëzojë ndihmën e mbrojtësit që e zgjedh vet ose t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike; 1.6. të informohet për numrin maksimal të orëve që mund të privohet nga liria para se të sjellet para gjyqtarit; 1.7. të kundërshtojë ligjshmërinë e arrestit ose të bëjë kërkesë për lirim; 1.8. për arrestimin e tij të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij; dhe 1.9. të ketë kontroll dhe trajtim mjekësor, duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik.

2. Kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të njoftojë ose të kërkojë të njoftohet dhe të komunikojë gojarisht apo me shkrim me ambasadën, zyrën ndërlidhëse apo me misionin diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është ai, ose me përfaqësuesin e organizatës kompetente ndërkombëtare kur ai është refugjat ose është nën mbrojtjen e ndonjë organizate ndërkombëtare.

KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE
KODI NR. 08/L-032 I
PROCEDURËS PENALE

decisionTitle*

decisionDescription*

BROZICEK v.
ITALY

Shkelje e nenit 6 para 1 i KEDNJ-se.

19 Dhjetor 1989

[10964/84](#)

decisionTitle***decisionDescription***

Kamasinski kundër Austrisë (1998) 9783/82

Kamasinski
kundër Austrisë
(1998)

Parashtruesi paraqiti këtë padi duke pretenduar shkeljet e neneve 6, 13 dhe 14 gjatë procedurës së tij penale që rezultoi për shkak se ai nuk mund të fliste gjermanisht. Aplikanti pretendoi se autoritetet në shumë procedura penale nuk arritën të kujdeseshin për pamundësinë e tij për të folur gjermanisht. Në mënyrë të veçantë, ai u ankua për ndihmën joadekuate ligjore dhe interpretuese që ai mori gjatë të gjitha fazave të procedimit penal; domethënë: gjyqin e tij të parë, si dhe ankesat e mëvonshme

Gjykata u shpreh se autoritetet austriake shkelën nenin 6 (1), sepse hetimi faktik i kryer nga gjykatat austriake ishte në mënyrë të njëanshme dhe kërkuesi nuk ishte në gjendje të mbronte interesat e tij.